

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Zhvillimi i testeve për vlerësimin e sigurisë së rrjetit të sistemeve TIK dhe auditimi i proceseve të administrimit” .

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbimet e vlerësimit dhe inspektimit për sigurimin e cilësisë 72225000-8 dhe Shërbimet e testimit të softwareve 72254100-1

Vlera e Fondit Limit: 8.750.000 (tetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1*

d. *Lista e çmimeve të shërbimeve sipas Shtojcës 2*

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose

pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019,2020,2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës përkatësisht 3.500.000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, 55/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar". Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41/3, nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 9001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 20000-1 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

2.3.4 Standartin ISO 27001 (ose ekuivalente) për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë ne përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes).

Argumentimi 2.3.2, 2.3.3 dhe 2.3.4:

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

... “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

- ✓ ISO 9001 (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

- ✓ Standardi ISO 20000-1 (ose ekuivalente) përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit.

ISO 20000-1 është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të shërbimeve përgjatë afatit të zbatimit të kontratës, sipas kërkesave të DST-së.

Kjo çertifikatë ose ekuivalente e saj, siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet që do të realizohen përgjatë kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

- ✓ ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :
 - mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
 - aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
 - aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
 - aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Kërkesa për standardin ISO 27001 është e lidhur ngushtësisht dhe drejtëpërdrejt me objektin e kontratës sipas së cilës ndër të tjera kërkohet:

... “

- *Të evidentojë pikat e dobëta nga jashtë duke aplikuar teknika dhe mjete informatike dhe procedurale për evidentimin e dobësive dhe mundësive të depërtimit të sistemeve.*
- *Të evidentojë nivelin e riskut në formë të detajuar i klasifikuar sipas:*
 1. *Proceseve të punës teknike.*
 2. *Softwareve të përdorur dhe nivelin e sigurisë së tyre.*
 3. *HW apo arkitekturës së përzgjedhur apo aplikuar gabim në nivel konceptual dhe teknik;*
- *Të evidentojë rrezikun që vjen nga stafi i Institucionit.*
- *Të evidentojë rrezikun që vjen nga sulmet kibernetike si dhe nivelin e vështirësisë së depërtimit në rrjet.*
- *Të përgatisë raportet paraprake dhe përfundimtare me problematikat e evidentuara dhe me rekomandimet e nevojshme.*
- *Të përgatisë një udhërrëfyes në formën e projekt propozimi për ndryshimet në procedurat e punës së stafit teknik të IT me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë informatike...”*

Realizimi i sa më sipër, kërkon ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese si dhe në informacione sensitive të Institucionit, si rrjedhojë është një garanci e nevojshme dhe e rëndësishme aplikimi i

praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve dhe për trajtimin e të dhënave sensitive të shërbimeve që do të kryhen.

Aksesi në infrastrukturën qendrore TIK të Bashkisë Tiranë dhe aksesi në informacion do të jetë i kontrolluar e i monitoruar nga stafi i Bashkisë, megjithatë certifikimi ISO 27001 për operatorin ekonomik është një garanci e nevojshme për Autoritetin Kontraktor.

Referuar sa më sipër, disponueshmëria e certifikatës ISO 27001, parë kjo në raport me natyrën e shërbimeve të kërkuara, trajtimin e informacionit konfidencial gjatë implementimit të saj, kërkesa e mësipërme është një kërkesë në përpjesëtim me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet nga Autoriteti Kontraktor. Dhe është një kërkesë e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.5 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës operatori ekonomik duhet të disponojë staf të kualifikuar, me kontratë të vlefshme pune/angazhimi me eksperiencë prej të paktën 3 vite në auditimin e sistemeve të informacionit, ose ekuivalente që do të angazhohen në realizimin e kontratës, sipas kualifikimeve minimale të mëposhtme:

2.3.5/a) 1 (një) punonjës të certifikuar CISA (Certified Information Security Audit), ose ekuivalent;

2.3.5/b) 1 (një) punonjës të certifikuar CISSP, (Certified Information Systems Security Professional), ose ekuivalent;

2.3.5/c) 1 (një) punonjës të certifikuar CISM (Certified Information Security Manager), ose ekuivalent;

2.3.5/d) 1 (një) punonjës të specializuar në fushën e qeverisjes së teknologjisë së informacionit nga pikëpamja e sigurisë, për institucionet publike (diplomë studimesh ose me certifikatë të vlefshme).

Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

1. CV
2. Librezë pune ose në rast të mosdisponimit të Librezës së Punës, Vërtetim mbi bazën e vlerësuar “Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore (pas datës 01.01.2012)”
3. Çertifikatat/Diplomat përkatëse për specialistët e kërkuar
4. Kontratë pune/ angazhimi.
5. Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emër mbiemër) dhe profilin përkatës (çertifikimet respektive);

Kriteri 2.3.5 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Neni 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

Argumentimi: Kërkesa për staf është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), Neni 41, pika 4, ku citohet:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- d) ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Argumentimi për kërkesën: 2.3.5/a) 1 (një) punonjës të certifikuar CISA (Certified Information Security Audit), ose ekuivalent;

Certifikimi CISA, ose ekuivalent, është një standard i njohur globalisht për vlerësimin e njohurive, ekspertizës dhe aftësive të një auditori të IT-së në vlerësimin e dobësive dhe vendosjen e kontrolleve të IT-së në një organizatë/ Institucion.

Ky certifikim përfshin detyrat:

- Zbatimi i një strategjie auditimi për sistemet e informacionit (IS) që bazohet në menaxhimin e rrezikut.
- Planifikimi i auditimeve që mund të përdoren për të përcaktuar nëse asetet e IT-së janë të mbrojtura, të menaxhuara dhe të vlefshme.
- Kryerja e auditimeve në përputhje me standardet dhe objektivat e përcaktuara të organizatës.
- Ndarja e rezultateve të auditimit dhe ofrimi i rekomandimeve mbi menaxhimin bazuar në këto rezultate.

Për sa më sipër, ky certifikim është i lidhur me një nga detyrat që kërkohen të realizohen, objekt kontrate, konkretisht:

....“FAZA III REALIZIMI I IT AUDIT

Përgjatë kësaj faze do të hartohen pyetësorët për të vlerësuar nivelin e sigurisë në Institucion, maturitetin e përdoruesve, ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me sigurinë e sistemeve të informacionit, si dhe rëndësia e të dhënave që ato trajtojnë. Një pjesë e rëndësishme e këtij projekti do të jetë dhe Auditimi i procedurave, rregulloreve që duhet të përcaktojnë mënyrën e administrimit të sigurt të teknologjisë së informacionit në përputhje me standardet ndërkombëtare të Sigurisë së Informacionit. Auditimi duhet të zhvillohet me referencë standardet ISO27000 dhe standardet ndërkombëtare të sigurisë së informacionit. Në procesin e auditit BT do të mundësojë të gjitha takimet e nevojshme ashtu si kërkohen nga OE për të mundësuar plotësimin sa më të saktë të procesit...”

Certifikimi CISA ose ekuivalent, garanton Autoritetin Kontraktor që OE zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për realizimin e detyrave të kërkuara si auditimin e procedurave, rregulloreve, mënyrën e administrimit të sigurt të teknologjisë së informacionit në përputhje me standardet ndërkombëtare të Sigurisë së Informacionit, objekt kontrate si dhe principet e auditimit të sistemeve të informacionit. Një pjesë e këtij kriteri, në kontekstin e objektit të prokurimit, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantojë cilësinë e procesit të auditimit të sistemeve si dhe besueshmërinë e rekomandimeve që do të lihen AK, në fund të proceseve përkatëse. Për sa më sipër, ky certifikim garanton AK se OE ka në stafin e tij punonjës të kualifikuar.

Argumentimi: 2.3.5/b) 1 (një) punonjës të certifikuar CISSP, (Certified Information Systems Security Professional), ose ekuivalent;

CISSP (Certified Information Systems Security Professional) ose ekuivalent, është një standard i njohur globalisht për të gjithë ata që punojnë në fushën e sigurisë së informacionit. Standardi CISSP fokusohet në implementimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e sigurisë së sistemeve të informacionit.

Ky certifikim përfshin:

- Sigurinë e aseteve
- Sigurinë e komunikimit dhe të rrjetit
- Menaxhimin e identitetit dhe aksesit.
- Vlerësimi dhe testimi i sigurisë
- Operacionet e sigurisë
- Menaxhimi i sigurisë dhe riskut
- Siguria e aplikacioneve SW

Për sa më sipër dhe referuar kontratës që kërkohet të realizohet, angazhimi i punonjësve që kanë këtë lloj kualifikimi, lidhen në mënyrë direkte me implementimin e detyrave të kërkuara si:

.. “FAZA II REALIZIMI I TESTIMEVE NGA JASHTË (BLACK BOX-BB)

Për realizimin e testeve në të cilat do të përfshihet rrjeti kompjuterik, perimetri i jashtëm, sistemet, aplikacionet website-e, sistemet mbrojtëse dhe niveli i konfigurimit të tyre, nëpërmjet kësaj kontrate do të realizohet aplikimi i testeve nga jashtë rrjetit të Bashkisë Tiranë duke vënë në dispozicion vetëm informacion minimal – emri i domainit dhe adresa IP e jashtme (96 IP) publike që janë në përdorim të BT. Objektet e testeve janë përcaktuar (por nuk kufizohen në) në paragrafin e specifikimeve teknike.

FAZA IV REALIZIMI I TESTIMEVE BRENDA (WHITE BOX-WB)

Testime White Box – Testime të cilat do të zhvillohen nga brenda rrjetit, duke u fokusuar në infrastrukturën e rrjetit të brendshëm, Active Directory, Sistemin e emailit/Exchange, aplikacionet dhe databazat, pajisjet Hardware, me qëllim evidentimin e çdo kërcënimi që vjen nga brenda institucionit dhe vlerësimin e rreziqeve që vijnë si pasojë e keqpërdorimit të aseteve TIK hardware dhe software, nga aktiviteti i jashtëm që përfton akses në mënyrë të paautorizuar dhe/ose nga vet stafi i institucionit...”

1 (një) punonjës i çertifikuar CISSP, (Certified Information Systems Security Professional), ose ekuivalent është garanci për Autoritetin Kontraktor që zhvillimi i testeve dhe vlerësimi i sigurisë së sistemeve të informacionit të realizohet në kohë me cilësi dhe sipas standardeve ndërkombëtare.

Ky certifikim garanton AK që OE ka në stafin e tij punonjës të certifikuar në fushën e sigurisë së informacionit të cilët zotërojnë njohuritë e nevojshme për të kuptuar gjithë aspektet e sigurisë së informacionit dhe aftësitë për ti zbatuar ato në praktikë.

CISSP (Certified Information Systems Security Professional), ose ekuivalent, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

Argumentimi për kërkesën: 2.3.5/c) 1 (një) punonjës të certifikuar CISM (Certified Information Security Manager), ose ekuivalent;

Certifikimi CISM është një nga certifikimet më prestigjioze në fushën e menaxhimit të sigurisë. 1 (një) punonjës i certifikuar si CISM (Certified Information Security Manager), ose ekuivalent,

vërtetohet se operatori ekonomik ka në stafin e tij punonjës të aftë për dizenjimin, zbatimin dhe menaxhimin e rrjetit të sigurisë së një organizate.

Një punonjës i certifikuar si CISM (Certified Information Security Manager), ose ekuivalent, është i aftë të menaxhojë:

- Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së informacionit
- Menaxhimi i riskut të informacionit
- Zhvillimi dhe menaxhimi i programit të sigurisë së informacionit

Gjithashtu një punonjës i certifikuar si CISM ose ekuivalent, është i aftë të identifikojë kërcënimet e mundshme dhe të parandalojë dëmet në rast të shkeljeve të sigurisë.

Për sa më sipër, bazuar në kompleksitetin e procedurës, duke marrë parasysh se stimulimi i sulmeve që kërkohet mund të hasë në situata të paparashikuara, është e nevojshme dhe e rëndësishme prania e një menaxheri të sigurisë së informacionit i cili të mund të hartojë dhe dizenojë një plan të mirëdetajuar të zhvillimit të të gjithë detyrave të kërkuara duke mbajtur në konsideratë menaxhimin e incidenteve nëse do të ketë, menaxhimin e riskut të informacionit, si dhe të menaxhojë të gjithë fazat e kërkuara.

Argumentimi për kërkesën: 2.3.5/d) 1 (një) punonjës të specializuar në fushën e qeverisjes së teknologjisë së informacionit nga pikëpamja e sigurisë, për institucionet publike (diplomë studimesh ose me çertifikatë të vlefshme).

Qeverisja e teknologjisë së informacionit nga pikëpamja e sigurisë ka të bëjë me strukturat, proceset dhe mekanizmat që lidhen me sigurinë e informacionit. Angazhimi i stafit që ka njohuri të certifikuar në këtë fushë, është garanci që rekomandimet e kërkuara në përfundim të procesit të vlerësimit të sigurisë dhe auditimit të sistemeve të jenë jo vetëm në përputhje me kornizat moderne të qeverisjes dhe menaxhimit të sigurisë së informacionit por të jenë të përshtatshme dhe implementueshme për Autoritetin Kontraktor duke marrë në konsideratë specifikat që ka sektori publik. Ky kriter lidhet sidomos me fazën V, pjesë të termave të referencës:

“... FAZA V RAPORTIMI / PREZANTIMI I GJETJEVE”

Në përfundim të testimeve dhe auditit, OE do të përgatisë raportin përfundimtar për Bashkinë Tiranë. Produkti i këtij raporti do të japë në mënyrë të qartë dhe të bazuar në të dhëna teknike, detajet mbi çdo dobësi të rrjetit, të sistemeve operative, të aplikimeve si dhe format dhe metodat se si mund të thyhen dhe gjithashtu përshkrimet se si mund të riparohen, ndryshohen apo mbrohen dobësitë dhe si mund të ulet gjurma apo sipërfaqja e sulmeve që paraqesin sistemet informatike të Bashkisë Tiranë. Gjithashtu raporti do të prezantojë gjetjet mbi pajtueshmërinë e me standardet ISO 27000 në lidhje me proceset e punës, procedurat rregulloret dhe mënyrën e menaxhimit të TIK brenda Institucionit...”

Për sa më sipër, për përgatitjen e raportit përfundimtar me gjetjet, procedurat dhe mënyrën e menaxhimit të TIK brenda Institucionit, si dhe mbështetur në objektin, natyrën dhe përmasat e

kontratës kërkesa e mësipërme është një domosdoshmëri për implementimin me sukses të kontratës.

Në vijim të arsyetimit, referuar proceseve delikate që do të kryhen nëpërmjet kësaj kontrate, referuar rëndësisë së infrastrukturës dhe shërbimeve që ofrohen nëpërmjet saj për proceset e brendshme të punës në Institucion dhe në kuadër të shërbimeve që ofrohen për komunitetin, konsiderohet e rëndësishme eksperiencia minimale prej të paktën 3 (tre) vjet e stafit që do të angazhohet në implementimin e kontratës, në mënyrë që të aplikohen me profesionalizëm gjithë objektivat e kontratës pa cënuar asnjë aspekt të infrastrukturës TIK në Institucion.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Qëllimi i këtij projekti është të përcaktojë nivelin e sigurisë së sistemeve informatike të instaluar në Institucion.

Objektivat e projektit

Operatori ekonomik nëpërmjet kësaj kontrate duhet të arrijë objektivat:

- Të evidentojë pikat e dobëta nga jashtë duke aplikuar teknika dhe mjete informatike dhe procedurale për evidentimin e dobësive dhe mundësive të depërtimit të sistemeve.
- Të evidentojë nivelin e riskut në formë të detajuar i klasifikuara sipas:
 4. Proceseve të punës teknike.
 5. Softwareve të përdorur dhe nivelin e sigurisë së tyre.
 6. HW apo arkitekturës së përzgjedhur apo aplikuar gabim në nivel konceptual dhe teknik;
- Të evidentojë rrezikun që vjen nga stafi i Institucionit.
- Të evidentojë rrezikun që vjen nga sulmet kibernetike si dhe nivelin e vështirësisë së depërtimit në rrjet.
- Të përgatisë raportet paraprake dhe përfundimtare me problematikat e evidentuara dhe me rekomandimet e nevojshme.
- Të përgatisë një udhërrëfyes në formën e projekt propozimi për ndryshimet në procedurat e punës së stafit teknik të IT me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë informatike.

Specifikimet teknike të këtij shërbimi, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Zhvillimi i testeve për vlerësimin e sigurisë së rrjetit të sistemeve TIK dhe auditimi i proceseve të administrimit”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- *Dokumentat e tenderit*
- *Termet e referencës/ specifikimet teknike*